



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 20

Tiranë – E martë, 17 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 1/2015 datë 29.1.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen në programin e unionit “Fiscalis 2020”..... 1099
Ligj nr. 2/2015 datë 29.1.2015	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar”..... 1103
Vendim i Kuvendit nr. 18/2015, datë 5.2.2015	Për emërimin e zotit Gent Sejko Guvernator i Bankës së Shqipërisë... 1103
Vendim i Kuvendit nr. 19/2015, datë 5.2.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 8911, datë 27.1.2015, “Për disa ndryshime në dekretin nr. 8304, datë 11.10.2013, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave””..... 1103
Vendim i Kuvendit nr. 20/2015, datë 5.2.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit..... 1104
Vendim i Kuvendit nr. 21/2015, datë 5.2.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Zhvillimit Urban..... 1104
Vendim i Kuvendit nr. 22/2015, datë 5.2.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes..... 1104
Vendim i Kuvendit nr. 23/2015, datë 5.2.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.. 1104
Vendim i Kuvendit nr. 24/2015, datë 5.2.2015	Për caktimin e kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 1105

Vendim i Kuvendit nr. 25/2015, datë 5.2.2015	Për caktimin e kohëzgjatjes së mandatit të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	1105
Vendim i Kuvendit nr. 26/2015, datë 5.2.2015	Për caktimin e kohëzgjatjes së mandatit të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	1105
Vendim i Kuvendit nr. 27/2015, datë 5.2.2015	Për caktimin e kohëzgjatjes së mandatit të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	1106
Vendim i Kuvendit nr. 28/2015, datë 5.2.2015	Për ngritjen e nënkomisionit “Për administratën publike”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.....	1106
Vendim i Kuvendit nr. 29/2015, datë 5.2.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 57/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”.....	1106
Vendim i Kuvendit nr. 30/2015, datë 5.2.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 58/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të drejtat e njeriut”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”.....	1107



LIGJ
Nr. 1/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN
NË PROGRAMIN E UNIONIT
“FISCALIS 2020”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen në programin e unionit “Fiscalis 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.1.2015

**Shpallur me dekretin nr. 8951, datë 11.2.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
UNIONIT “FISCALIS 2020”**

Komisioni Evropian, me poshtë i quajtur “Komisioni”, në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është lidhur më 2 qershor 2005 ndërmjet Komisionit Evropian dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e cila vendosi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen në Programet e Komisionit¹. Neni 5 i Marrëveshjes parashikon termat dhe kushtet specifike, përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në çdo program të veçantë që do të përcaktohet nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë.

2. Neni 1 (2) i Marrëveshjes Kuadër lejon Republikën e Shqipërisë të marrë pjesë në Programet e Unionit të vendosura ose të rinovuara pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kuadër dhe që përmban një klauzolë të hapur për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë.

3. Programi “Fiscalis 2020”, u vendos në bazë të udhëzimit nr. 1286/2013 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian.²

4. Në pikën “a” të nenit 3 (2) të udhëzimit nr. 1286/2013, programi “Fiscalis 2020” është i hapur për pjesëmarrjen e vendeve të aprovuara, vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë që përfitojnë nga strategjia e para-anëtarësimit, në përputhje me dispozitat që do të përcaktohen me ato vende pas themelimit të Marrëveshjeve Kuadër në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në programet e Unionit.

5. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka shprehur dëshirën për të marrë pjesë në programin e “Fiscalis 2020” dhe ka negociuar me Komisionin mbi marrëveshjen për kushtet specifike, përfshirë kontributin financiar për pjesëmarrjen e saj në program.

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi

Republika e Shqipërisë do të marrë pjesë në programin “Fiscalis 2020”:

a) në përputhje me kushtet e parashtruara në Marrëveshjen Kuadër të lidhur më 2 qershor 2005 ndërmjet Komisionit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit; dhe

b) nën kushtet e neneve 2-4 të kësaj Marrëveshjeje.

¹FQ L 192,22.07.2005, fq.2

²FQ L 347,20.12.2013, fq.25



Neni 2

Kushtet e pjesëmarrjes në Program

1. Republika e Shqipërisë do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren (BE) nr. 1286/2013 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian.

2. Republika e Shqipërisë do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me kushtet dhe kalendarin e mëposhtëm:

a) Pjesëmarrja në aktivitete është specifikuar në pikat “a” dhe “c” të nenit 7 (1) të rregullores nr. 1286/2013, përveç rasteve kur natyra ose përmbajtja e aktivitetit pengon pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë.

b) Me kusht që kërkesat përkatëse ligjore të jenë vendosur, pjesëmarrja në veprimtaritë e krijimit të sistemeve evropiane të informacionit specifikohet në pikën “b” të nenit 7 (1) të rregullores nr. 1286/2013. Pjesëmarrja në aktivitete do të fillojë në datën e rënë dakord nga të dyja palët në nivel të menaxhimit të programit.

3. Kushtet e paraqitjes, të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së pjesëmarrësve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucione, organizata dhe individë të pranueshëm të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të njëjta me ato të institucioneve, organizatave dhe individëve të pranueshëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Republika e Shqipërisë duhet të paguajë çdo vit një kontribut financiar në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian sipas nenit 3.

5. Kontributi financiar i Republikës së Shqipërisë duhet t'i shtohet çdo vit shumës së buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian, i cili është i rezervuar në ndarjet buxhetore për të përmbushur detyrimet financiare të mëtejshme dhe masat e ndryshme të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

6. Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian duhet të përdoret për procedurat e lidhura me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat e kontributit financiar të Republikës së Shqipërisë janë përcaktuar në aneksin I.

Rregullat e kontrollit financiar, rikuperimit dhe masave të tjera kundër mashtrimit janë të përcaktuara në aneksin II.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Komisioni, në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, do të monitorojë vazhdimisht pjesëmarrjen në Program të Republikës së Shqipërisë. Kjo dispozitë nuk ndikon në përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike të vendosura nga Bashkimi Evropian në këtë kontekst.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Marrëveshja do të zbatohet gjatë kohëzgjatjes së Programit. Nëse Bashkimi Evropian gjatë kohëzgjatjes së saj nuk pëson ndonjë ndryshim thelbësor në Program, si rrjedhojë kjo Marrëveshje do të zgjerohet programin automatikisht, nëse një nga Palët nuk e denoncon brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të aktit ligjor që zgjeron programin.

Pas përfundimit të Marrëveshjes, do të vazhdohet si më poshtë:

a) Projektet dhe aktivitetet në progres në kohën e përfundimit deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

b) Masat kontraktuale të zbatueshme për këto projekte dhe aktivitete, dhe

c) Dispozitat e aneksit 2.

Anekset do të formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Komisionin që janë përmbushur kërkesat e saj të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga data 1 janar 2015.



Përfunduar në.....më.....

Përfunduar në Bruksel më 8.09.2014

Për Republikën e Shqipërisë
Znj. Brisida Shehaj
 Drejtore e Përgjithshme e Tatimeve e
 Republikës së Shqipërisë

Për Komisionin, në emër të Bashkimit
 Evropian,
Z. Heinz Zourek
 Drejtor i Përgjithshëm i Unionit Tatimor dhe
 Doganor

ANEKSI I MARRËVESHJES
RREGULLAT PËR KONTRIBUTIN
FINANCIAR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË FISCALIS 2020

1. Kontributi financiar që Republika e Shqipërisë duhet të paguajë në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të jetë si më poshtë:

a) Për veprimtaritë e përmendura në pikën “a” të nenit 2 (2) të kësaj Marrëveshjeje, shumë renditen si më poshtë:

- 25,000 euro për vitin 2015;
- 30,000 euro për vitin 2016;
- 35,000 euro për vitin 2017;
- 40,000 euro për vitin 2018;
- 45,000 euro për vitin 2019;
- 50,000 euro për vitin 2020.

b) Për veprimtaritë e përmendura në pikën “b” të nenit 2 (2) të kësaj Marrëveshjeje, një shumë vjetore prej 120.000 euro që nga viti kur Republika e Shqipërisë përdor CCN/CSI³ për qëllimet e aktiviteteve të lidhura.

2. Kontributi i Republikës së Shqipërisë duhet të mbulojë shpenzimet që lidhen me:

a) pjesëmarrjen e zyrtarëve të administratës tatimore të Republikës së Shqipërisë në aktivitetet e programit sipas pikës “a” të nenit 2 (2) të kësaj Marrëveshjeje;

b) pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në aktivitetet e parashikuara në pikën “b” të nenit 2 (2) të kësaj Marrëveshjeje;

3. Komisioni duhet të rimbursojë shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit të përfaqësuesve dhe ekspertëve të Republikës së Shqipërisë, ku marrin pjesë si vëzhgues:

- në komitetin e përmendur në nenin 15 të rregullores që miraton Programin; ose
- në takimet e tjera që lidhen me zbatimin e Programit.

Rimbursimi duhet të jetë në të njëjtat kushte dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

4. Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012⁴, për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, duhet të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Republikës së Shqipërisë.

5. Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe në fillim të çdo viti buxhetor pasues, Komisioni duhet t’i dërgojë Republikës së Shqipërisë një ftesë për fondet përkatëse për kontributin e saj financiar.

6. Ky kontribut duhet të paguhet në euro në një llogari bankare (në euro) të Komisionit.

7. Republika e Shqipërisë duhet të paguajë kontributin e saj financiar jo më vonë se tre muaj pas datës së ftesës në përputhje me kërkesën e fondeve. Republika e Shqipërisë do të paguajë interes kamatëvonesë mbi shumën e papaguar nga data e kërkuar në rast vonese për pagesën e kontributit. Norma e interesit:

- do të zbatohet nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç është publikuar në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian;

- do hyjë në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajve në të cilën bie afati; dhe

- do të rritet me 3.5 pikë për qind.

Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në program për vitin përkatës do të pezullohet nëse Republika e Shqipërisë nuk paguan brenda 20 ditësh pune, pasi Komisioni i dërgon një letër zyrtare për kujtesë, dhe në rast se vonesa për pagesën rrezikon në mënyrë të konsiderueshme zbatimin dhe menaxhimin e programit.

³ CCN/CSI: “Rrjeti i zakonshëm i komunikimit/nderfaqja e sistemeve të zakonshme”, siç janë përmendur në Aneksin e Rregullores nr. 1286/2013

⁴FZ L 298, 26.10.2012, fq. 1



ANEKSI II I MARRËVESHJES KONTROLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASAT E TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollat dhe masat kundër mashtrimit sipas Unionit

1. Në përputhje me Rregulloren Financiare të Zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe grantet e përfunduara me kontraktuesit dhe përfituesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojnë që:

- kontrollat financiare apo kontrole të tjera mund të kryhen në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose grant - marrëveshjes për një periudhë prej 5 vitesh, duke filluar nga data e pagesës së bilancit;

- në kushtet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve, dhe në kushtet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre.

- nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni duhet të kenë akses në faqet, punën, dokumentet dhe të gjithë informacionin e kërkuar, duke përfshirë edhe formën elektronike, me qëllim kryerjen e kontroleve. E drejta e aksesit duhet të parashikohet shprehimisht në kontratat dhe grant - marrëveshjet e lidhura për zbatimin e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Komisioni/ OLAF (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrole dhe inspektime në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të rregullores së Këshillit (Euratom EC) nr.2185/96 të datës 11 nëntor 1996.

Këto kontrole dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e Republikës së Shqipërisë të përcaktuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë. Këto autoritete duhet të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ata të mund të na ndihmojnë në rast nevojë.

Nëse autoritetet e Republikës së Shqipërisë dëshirojnë, kontrollat dhe inspektimet në terren mund të kryhen së bashku me ta.

Nëse pjesëmarrësit në program kundërshtojnë një kontroll ose inspektim në terren, autoritetet e Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në përputhje me rregullat e brendshme, i japin inspektorëve të Komisionit/OLAF ndihmën e nevojshme për t'i lejuar që ata të kryejnë punën e tyre.

Komisioni/OLAF i raporton çdo fakt ose dyshim të ndonjë parregullsie të vërejtur gjatë verifikimeve apo inspektimeve në terren autoriteteve të Republikës së Shqipërisë. Komisioni/OLAF në çdo rast duhet të informojë autoritetet për rezultatin e këtyre kontroleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsulenca

1. Për zbatimin e këtij aneksi autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet e Bashkimit Evropian duhet të shkëmbejnë informacion dhe të konsultohen me njëri-tjetrin, nëse kërkohet nga njëra palë.

2. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë duhet të informojnë menjëherë Komisionin për çdo fakt apo dyshim për parregullsi në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kontratës dhe grant - marrëveshjet e përfunduara në zbatim të instrumenteve sipas kësaj Marrëveshjeje.

III. Masat administrative dhe gjobat

Komisioni mund të vendosë masa administrative dhe gjoba në përputhje me Udhëzimin Financiar të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian, pa ndikimin e zbatimit të së drejtës penale të Republikës së Shqipërisë.

IV. Rikuperimi

Komisioni mund të marrë vendime duke i caktuar një detyrim financiar personave të cilët nuk janë nga vendet anëtare. Këto vendime duhet të ekzekutohen në përputhje me rregullat e procedurës civile në fuqi në territorin e vendit ku është kryer ekzekutimi. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë duhet të informojë autoritetet kombëtare të Komisionit që është caktuar për qëllimin e zbatimit. Komisioni do të kërkojë nga Autoriteti Kombëtar që të verifikojë vërtetësinë e vendimit para se urdhri i zbatimit t'i bashkëlidhet vendimit. Pas përfundimit të këtyre formaliteteve, Komisioni mund të zbatojë



vendimin e tij në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërsëdrejti tek autoriteti i caktuar.

Ligjshmëria e vendimit të Komisionit duhet t'i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, bazuar në dispozitat e kontratës dhe grant-marrëveshjet, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të ekzekutohen me të njëjtat kushte.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni duhet të komunikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë me përfituesit dhe kontraktuesit e programit Fiscalis 2020, i vendosur në Republikën e Shqipërisë. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse, të cilat janë kërkuar të paraqiten mbi bazën e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshjeje dhe të kontratave dhe grant-marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e tyre.

LIGJ
Nr. 2/2015

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 2, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 185/2013 “PËR BUXHETIN E VITIT
2014”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar”.

Miratuar në datën 29.1.2015

**Shpallur me dekretin nr. 8952, datë 11.2.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 18/2015

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT GENT SEJKO
GUVERNATOR I BANKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 161 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gent Sejko emërohet në detyrën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 19/2015

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR.
8911, DATË 27.1.2015, “PËR DISA
NDRYSHIME NË DEKRETIN NR. 8304,
DATË 11.10.2013, “PËR EMËRIMIN E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE””**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 8911, datë 27.1.2015, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8911, datë 27.1.2015, “Për disa ndryshime në dekretin nr. 8304, datë 11.10.2013, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave””, me ndryshimet e mëposhtme:

“Në nenin 1, pikat 9 dhe 10 ndryshohen si më poshtë:



9. Zonja Eglantina Gjermani, Ministre e Zhvillimit Urban;

10. Zoti Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 20/2015

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË
ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 8912, datë 27.1.2015, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8912, datë 27.1.2015, për shkarkimin e zonjës Eglantina Gjermani nga detyra e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 21/2015

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË
ZHVILLIMIT URBAN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 8913, datë 27.1.2015, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8913, datë 27.1.2015, për emërimin e zonjës Eglantina Gjermani në detyrën e Ministrit të Zhvillimit Urban.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 22/2015

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
SHKARKIMIN E MINISTRIT TË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 8914, datë 27.1.2015, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8914, datë 27.1.2015, për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj nga detyra e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 23/2015

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIT TË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 8915, datë 27.1.2015, të Presidentit të Republikës,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8915, datë 27.1.2015, për emërimin e zotit Arben Ahmetaj në detyrën e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 24/2015

**PËR CAKTIMIN E KRYETARIT TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61, pika 6, të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pirro Xhixho caktohet Kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare me mandat 5-vjeçar.

II. Mandati 5-vjeçar fillon nga data e emërimit të tij si anëtar i Këshillit Drejtues.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 25/2015

**PËR CAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË
MANDATIT TË NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61, pika 6, të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mandati i zonjës Anila Denaj, si anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është 4-vjeçar.

II. Mandati 4-vjeçar fillon nga data e emërimit të saj si anëtare e Këshillit Drejtues.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 26/2015

**PËR CAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË
MANDATIT TË NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61, pika 6, të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mandati i zonjës Klarina Allushi (Abazaj), si anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është 4-vjeçar.



II. Mandati 4-vjeçar fillon nga data e emërimit të saj si anëtare e Këshillit Drejtues.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 27/2015

**PËR CAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË
MANDATIT TË NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61, pika 6, të ligjit nr.102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mandati i zonjës Ketrin Topçiu, si anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është 3-vjeçar.

II. Mandati 3-vjeçar fillon nga data e emërimit të saj si anëtare e Këshillit Drejtues.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 28/2015

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
“PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE”, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E
NJERIUT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 1, 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,
Faqe | 1106

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për administratën publike”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është administrata publike.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|-----------------|------|
| 1. Blendi Klosi | Kryetar | (PS) |
| 2. Oerd Bylykbashi | Zëvendëskryetar | (PD) |
| 3. Vexhi Muçmata | Anëtar | (PS) |
| 4. Armando Subashi | Anëtar | (PS) |
| 5. Gent Strazimiri | Anëtar | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 29/2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 57/2013 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR
QEVERISJEN VENDORE”, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E
NJERIUT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, dhe 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 57/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, pika III ndryshohet si më poshtë:



“III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|------------------|-----------------|--------|
| 1. Bashkim Fino | Kryetar | (PS) |
| 2. Arben Ristani | Zëvendëskryetar | (PD) |
| 3. Dashamir Peza | Anëtar | (PS) |
| 4. Petrit Vasili | Anëtar | (LSI) |
| 5. Eduart Halimi | Anëtar | (PD)”. |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

VENDIM
Nr. 30/2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 58/2013 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR
TË DREJTAT E NJERIUT”, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E
NJERIUT”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, dhe 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 58/2013 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për të drejtat e njeriut”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, pika III ndryshohet si më poshtë:

“III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|-------------------|-----------------|--------|
| 1. Vasilika Hysi | Kryetare | (PS) |
| 2. Tahir Muhedini | Zëvendëskryetar | (PDIU) |
| 3. Pandeli Majko | Anëtar | (PS) |
| 4. Silva Caka | Anëtare | (LSI) |
| 5. _____ | Anëtar | (PR)”. |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 92 lekë